

VENDIMNr. 141 Datë 25.09.2020

PËR

**MIRATIMIN E DRAFT - DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr.10 Datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”, Udhëzimin plotësues nr.27 datë 10.07.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë draft dokumentin përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Kukës

KRYETARI I KESHILLIT**Anilda BIBA**